



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 06, dt. 15.06.2021

#### ***MBI MIRATIMIN E TRANSFERTËS TË KONTRIBUTIT FINANCIAR TË KËSHILLIT TË QARKUT NË BASHKINË DEVOLL PËR PROJEKTIN E PËRBASHKET ME SHOQATËN E BLETËRITËSVE***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 14 datë 22.12.2021” Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

### VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e kontributit financiar të Këshillit të Qarkut në Bashkinë Devoll, për Projektin e përbashkët me Shoqatën e Bletëritësve në vlerë 400 mijë lekë.
2. Fondi prej 400 mijë lekë do të mbulohet nga fondi i transfertës i miratuar për Shoqatën e Bletëritësve në Buxhetin fillestar të vitit 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit dhe Dega e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi O. Beqiraj  
Juristi Gj. Kristo  
Sek.K.Qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### ***MBI MIRATIMIN E TRANSFERTËS TË KONTRIBUTIT FINANCIAR TË KËSHILLIT TË QARKUT NË BASHKINË DEVOLL PËR PROJEKTIN E PËRBASHKËT ME SHOQATËN E BLETËRITËSVE***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 14 date 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2022”, Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit paraqet para Keshillit të Qarkut kërkesën për miratim të transferimit të kontributit financiar të Keshillit të Qarkut në Bashkinë Devoll për Projektin e përbashkët me Shoqatën e Bletëritësve.

Prej disa vitesh Këshilli i Qarkut në bashkëpunim me Shoqatën e Bletëritësve të Rajonit tonë ka financuar aktivitetet e kësaj Shoqate ku janë promovuar vlerat kurative të mjaltit dhe arritjet e teknologjive bashkëkohore të prodhimit dhe perpunimit të mjaltit. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë edhe bletërites dhe përpunues të mjaltit nga vendet e Ballkanit duke vendosur edhe bashkëpunime dhe kembim eksperiencash me shoqata të tjera.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Keshilli i Qarkut edhe për vitin 2022 ka miratuar një fond prej 400 mijë lekë në Buxhetin fillestar për mbështetjet e këtyre projekteve.

Per vitin 2022 është menduar që ky aktivitet të shtrihet edhe në zonen e Devollit duke e bërë pjesë të këtij Projekti edhe Bashkinë Devoll. Meqënëse aktivitetet kryesore të këtij Projekti do të zhvillohen në Bashkinë Devoll, me kërkesë të saj, propozojmë transferimin në Bashkinë Devoll të fondit prej 400 mijë lekë të miratuar për Shoqatën e Bletëritësve në Buxhetin fillestar të Keshillit të Qarkut për vitin 2022.

Mbështetur në kjo kërkesë, i propozojmë Keshillit të Qarkut miratimin e transferimit të kontributit financiar prej 400 mijë lekë të Keshillit të Qarkut në Bashkinë Devoll për projektin e përbashkët me Shoqatën e Bletëritësve.

Korçë, më 09.06.2022

Specialiste Finance  
Oljona Beqiraj